

VENDIM
Nr. 12/2020

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166, DATË 16.12.2004,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit a/4 shtohen nenet a/5, a/6 dhe a/7 me këtë përmbajtje:

“Neni a/5

Mbledhjet në rastet e masave të jashtëzakonshme

Në raste të masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësive natyrore, mbledhjet e seancës plenare dhe organeve të Kuvendit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

Seanca plenare mund të mbledhet edhe fizikisht me numër të reduktuar të deputetëve.

Kryetari i Kuvendit urdhëron zhvillimin e mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik të Konferencës së Kryetarëve, Byrosë së Kuvendit dhe Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Konferenca e Kryetarëve vendos zhvillimin e mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik të komisioneve parlamentare, si dhe zhvillimin e mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik ose me numër të reduktuar të deputetëve të seancës plenare.

Në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik, sipas parashikimeve të këtij neni, do të respektohen për aq sa mundet rregullat procedurale të parashikuara në Rregullore.

Neni a/6

Votimi në rastet e masave të jashtëzakonshme

Në rastet e masave të jashtëzakonshme, votimi mund të zhvillohet edhe me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, duke siguruar identifikimin e deputetëve, sipas rregullave të përcaktuara nga Kryetari i Kuvendit për Konferencën e Kryetarëve, Byronë e Kuvendit dhe Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe Konferenca e Kryetarëve për komisionet parlamentare dhe seancën plenare.

Në rastet e masave të jashtëzakonshme, kur në seancë plenare deputetët janë fizikisht, votimi zhvillohet sipas rregullave të përcaktuara nga Kryetari i Kuvendit.

Neni a/7
**Procedura e përshpejtuar e shqyrtimit të projektligjeve
në rastet e masave të jashtëzakonshme**

Në rastet e masave të jashtëzakonshme, Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, mund të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar më shumë se një projektligj në kalendarin 3-javor dhe më shumë se tre projektligje në kalendarin 9-javor.”.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet prej datës 11.3.2020.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.4.2020